

“Koha e kometës” një rrëfim ndryshe për “Vitin e mbrapshtë”

Ata që te filmi e kërkojnë romanin e plotë me ngjyra, ngjarje, zëra e fraza ndoshta do të zhgënjehen. Filmi “Koha e kometës” bazohet te romani “Viti i mbrapshtë”, por e zbut egërsinë e 1913- tës me një dashuri të fuqishme në shikim të parë...

Shkrimtari i njohur brazilian Paolo Coelho nuk dëshiron që romanet e tij të bëhen filma, ose e pranon shumë rrallë dhe me vështirësi një mundësi të tillë. Sipas tij romani dhe filmi janë dy medime të ndryshme e krejtësisht të kundërta.

Romanin njerëzit e lexojnë, e kuptojnë dhe e imagjinojnë individualisht, secili në mënyrën e vet. Edhe filmi shpesh nis si ide e vetëm një njeriu ose një ekipi të caktuar njerëzish, prandaj edhe ai e ka vulën e tyre dhe mund të mos pëlqehet domosdoshmërisht nga të gjithë.

Njësoj mund të jenë ndier lexuesit e romanit “Viti i mbrapshtë” të Ismail Kadaresë kur kanë parë filmin “Koha e kometës”. Ata mund të kenë pritur shumë më tepër, siç presin zakonisht të gjithë lexuesit e globit nga të gjitha romanet që “shfaqen” në ekran.

Nisen për luftë dhe gjejnë “luftën” tjetër- dashurinë

Skenari i filmit duket sikur është shkruar nga misionet e tashme ndërkombëtare të Kosovës. Që në fillim në Shqipërinë e atëhershme vie dhe pritet ngrohtësisht nga populli princ Vidi. Njeriu i cili për aq pak kohë sa qëndroi nuk mundi asnjëherë ta kontrollojë shtetin që i dhanë për ta administruar për shkak të rrethanave të krijuara, këtu paraqitet si hero. Luftëtarët shqiptarë luftojnë për të e nëpërmjet tij edhe për lirinë e tyre. Dëshira jonë për ta bërë veten



evropianë me çdo kusht pas gjithë asaj nate pesëshkullore aziatike është e kuptueshme dhe, edhe sot vazhdon.

Por në roman ndodh diçka tjetër. Çeta e luftëtarëve shqiptarë, e dalë nga një katund i humbur e malor i Shqipërisë, nuk lufton për princin austriak, por për ta mbrojtur tërësinë territoriale të vendit. Ata nuk mbërrijnë asnjëherë të takohen me princin, ndërsa në rastin më të mirë kryeqytetit të atëhershëm shqiptar Durrësit, i afrohen vetëm sa për t'ia parë nga larg dritat e shumta, pa pasur mundësi të hyjnë aty si triumfues e fitimtarë.

Një tjetër gjë që e dallon filmin nga romani është edhe dashuria.

Derisa në roman, njerëzve të zënë me luftën nuk u bie ndërmend ndjenja më fisnike, derisa në roman dashuria e kohës së luftës nuk është dashuri, por më shumë është ankth, në film shpërthen vullshëm dhe pandalshëm

dashuria në shikim të parë mes kapedanit të komitëve Shestani Verdhës (të luajtur mrekullueshëm nga Blerim Destani) dhe Anjezës, një vajze që dëshirojnë ta bëjnë murgeshë (të luajtur gjithashtu me profesionalizëm nga Masiela Lusha).

Shikimet plot pasion dhe pa fjalë mes këtyre dy të rinjve të kombinuara mjeshtërisht me natyrën mbresëlënëse të vendxhirimeve, i japin sharm e bukuri të veçantë filmit. Japin edhe mesazh të fortë se pavarësisht rrethanave dashuria mbijeton, si një lule në shkretëtirë.

Gjithmonë përzihen dasma e lufta

Edhe këtu, si në shumë raste tjera në jetën tonë, përzihen dasma e lufta. Këto dy gjendje krejt të kundërta. Si në ato rrëfimet e moçme për varret e krushqve, edhe te filmi “Koha e kometës” dasma zëvendëson luftën dhe



lufta dasmën. Nuk dihet ku fillon njëra e ku përfundon tjetra dhe anasjelltas. Në roman asnjëri nga luftëtarët nuk kthehet i gjallë në shtëpi, asnjëri nuk kthehet i gjallë në fshatin e vogël dhe të humbur. Krijohen legjenda për ta, për trimërinë e tyre. Pasi nuk u gjejnë as nam as nishan gjithnjë i presin që të kthehen. Dhe nuk u bën zemra ta besojnë vdekjen e tyre, edhe pse e dinë se diku nëpër Shqipëri ajo ka ndodhur. Në film pasi e kërkojnë luftën cep më cep të atdheut, atë luftën e madhe të furishme dhe finale, e nuk e gjejnë dot, luftëtarët kthehen të lodhur në shtëpi. Për ta pritur shfaqjen e sërishme të saj, Shestani shfrytëzon pauzën mes luftërash dhe martohet me Anjezën. Por lufta nuk vonon e kthehet përsëri duke i gjetur në mes të dasmës. Shestani si kapedan jep urdhrin e fundit: “Le të vazhdojë muzika...!” Dhe muzika vazhdon.../bm/

